

20250511125

Në bazë të nenit 83, paragrafi (3), nenit 84, paragrafi (1) dhe (2) dhe nenit 87 të Ligjit të Sigurimit të Detyrueshëm Pensional me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019 dhe 103/2021) dhe nenit 124, paragrafi (3), nenit 125, paragrafi (1) dhe (2) dhe nenit 128 të Ligjit të Sigurimit Vullnetar Pensional me Financim Kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 7/2008, 124/2010, 17/2011 dhe 13/2013 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 103/201) Këshilli i ekspertëve të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimit Pensional me Financim Kapital, në seancën e mbajtur më 25.2.2025, miratoi

RREGULLORE PËR NDRYSHIM TË RREGULLORES PËR VLERËSIM TË MJETEVE TË DETYRUESHME DHE VULLNETARE TË FONDEVE PENSIONALE

Neni 1

Në Rregulloren për vlerësimin e mjeteve të фондеве pensionale të detyrueshme dhe vullnetare (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 138/2008, 55/2013, 218/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 41/2019, 250/2019 dhe 103/2024) në nenin 8, paragrafi (1), pika a) ndryshohet si vijon:

“fondet e hapura investuese vlerësohen sipas vlerës së aksionit që është publikuar për herë të fundit nga Komisioni i Letrave me Vlerë jo më vonë se ora 08:00 e datës në të cilën bëhet vlerësimi i mjeteve të fondit pensional, kurse çmimi vlen për të gjitha datat për të cilat bëhet vlerësimi i mjeteve të fondit pensional;”

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Maqedonisë së Veriut.

Nr. 01-323/3
25.2.2025
Shkup

Kryetari
i Këshillit të Ekspertëve,
Maksud Ali d.v.